



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISE, TREGTISE DHE ENERJITIKES
DREJTORIA E SHERBIMEVE JURIDIKE

URDHER

Nr. 192, date 9.03.2008

PER PERCAKTIMIN E KRITEREVE TE PERGJITHSHME QE DUHET TE PLOTESOJE
KANDIDATI PER T'U KUALIFIKUAR SI METROLOG I AUTORIZUAR

Ne mbështetje të pikes 4, të nenit 100 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit nr.9875, datë 14.02.2008 “Për Metrologjinë”, neni 46, paragrafi 3, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë,

URDHEROJ:

1. Kriteret e përgjithshme që duhet të përmbushë kandidati për t’u kualifikuar si metrolog i autorizuar janë:

a- të përmbushë kërkesat për nivel arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale sipas pikes 2,

b- të jetë në kushte shëndetësore të mira për të kryer detyrat përkatëse,

c- të mos jetë denuar me vendim të formës së prirë të gjykatës për kryerjen e një krimi,

d- të mos jetë larguar nga puna për shkak të një shkelje të rëndë të disiplinës në punë.

2. Kriteret e veçanta (specifike) të jenë këto:

a- të ketë mbaruar shkollën e mesme profesionale në profilet mekanik, elektrik, ndërtim ose kimi

b- preferohet të jetë i diplomuar si inxhinier në degët mekanike, elektrike, elektronike, ndërtim ose në matematikë, fizikë, kimi, biokimi,

c- të ketë njohuri të mjaftueshme në fushën e metrologjisë ligjore, të testueshme në provimin e kualifikimit.

3. Të gjithë punonjësit ekzistues të DPM-së, që ushtrojnë detyrën e “metrologut të autorizuar” në qoftë se brenda një periudhe 5 vjeçare nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në pikën 2, nuk mund të ushtrojnë më tej këto detyra.

4. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

GENC RULI